



Kuvendi i Komunës Klinë

Nr prot. 06-32248/2024

Datë: 24.09/2024

Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 nën b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, Kornizën Afatmesme 2025-2027, nenin 40 paragrafi 2 nën pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 06.09.2024 dhe debatën me publikun më 04.09.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VIII- të të rregullt për vitin 2024 të mbajtur më 20.09.2024 mori këtë:

V E N D I M

Për

Aprovimin e propozim - buxhetit komunal për vitin 2025-2027 përfshirë projektet kapitale

1. Miratohet buxheti i Komunës së Klinës dhe projektet me prioritet për vitin 2025-2027.
2. Buxheti i Komunës së Klinës për vitin 2025 është në shumë totale prej 16,168,653 €.

| Kategoritë buxhetore | 2025 | 2026 | 2027 |
|-----------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| 1 Paga dhe mëditje | 8,892,032 | 9,381,094 | 9,878,292 |
| 2 Mallra dhe shërbime | 1,700,000 | 1,734,000 | 1,768,680 |
| 3 Komunalit | 370,000 | 386,650 | 405,983 |
| 4 Transfere dhe sub. | 800,000 | 840,000 | 907,200 |
| 5 Kapitale | 4,406,621 | 4,536,711 | 4,697,012 |
| TOTALI : | 16,168,653 | 16,878,455 | 17,657,167 |

3. Pjesë e këtij vendimi është buxheti si dhe projektet me prioritet për vitet 2025-2027 të cilat janë përfshirë në buxhet.
4. Kompetent për zbatimin e këtij Vendimi është Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim nga Kuvendi i Komunës konform nenit 81 të LVL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqe zyrtare të komunës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtorja për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi;



Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi